

**STATUT I SHOQERISE**  
**“FIRST CONSTRUCTION” Sh.P.K.**

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

Sot, më 01/12/2023, personat e mëposhtëm:

**Z. Arben Kocollari**, shtetas shqiptar, lindur më 04/05/1981 në Tiranë (ALB) e banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I10504162Q, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

**Znj.Serafima Abramovich**, shtetase izraelite, lindur me 18/06/1962 ne Moldova, e banuese ne Izrael , mbajtese e pasaportes me nr. 34468926, me nr personal 3-1400404-5, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

në përputhje me LigjinNr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligi” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 1 Dhjetor 2023, themeluesit e mësipërm, vendosën të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar **“FIRST CONSTRUCTION” SH.P.K.**

**Neni 2**  
**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shoqëria do të ketë si aktivitet: **Investitor ne ndertim. Shoqeria ne perputhje me ligjin material, mund te operoje ne fushen e ndertimit, restaurimit te godinave rezidenciale dhe jo-rezidenciale, objekteve civile, industriale, e monumentale si dhe punimet e lidhura me to, punime dhei, germime, punime betoni dhe punimeve te tjera armature e sovatime, punimeve te veprave publike per transportimin e gazrave te lengshem, ndertimin e rrugeve, autostradave, pistave aeroportuale, punime e germime arkeologjike.Ndertime dhe rikonstruksion godinash civile,ekonomike,veshje fasadash,mirembajtje dhe**

zhvillimi i dekoreve me mjetet urbane, prodhim materialesh inertesh e ndertime te tjera. Gjithashtu, Shoqeria mund te menaxhoje pasuri te paluajtshme, kryesish shit-blerjen, mirembajtjen, ristrukturim, qiradhenie si dhe veprimitari te tjera imobiliare, instalim, mirembajtje te sistemeve teknologjike, termike, kondicionimi i ajrit, sistemeve hidrosanitare, sisteme ashensori, shkalle levizese dhe transportuese, sistemet e parandalimit te zjarrit perfshire dhe ato te integruar, sistemet pneumatike, sistemet e sigurise, furnizim dhe instalim i artikuve prej metali, druri, plastike, guri, xhami si dhe ngjyrosjen e tyre. Shoqeria mund te kryeje edhe sherbime topografike, sherbime eksplorimi, rehabilitim i terreneve, sherbime shpimi, sherbime transporti (vinci, autobuse, teleferike, etj), duke u pajisur me autorizimet perkatese te parashikuara nga ligji ne fuqi.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*.

**Neni 4**  
**Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Kompleksi Lake View Residence, kulla c, kati 11, Tek Liqeni Artificial, Tirane.

Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra perfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

**Kreu II**  
**Kapitali**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 Leke (njeqind mijë leke), i ndare si me poshte:

- a. **Arben Kocollari**, mbajtes i nje kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit (me vlore 25,000 leke);
- b. **Serafima Abramovich**, mbajtes i nje kuote qe perfaqeson 75% te kapitalit (me vlore 75,000 leke);

Kontributi i ortakeve te paguhet nga ana e tyre, sipas vendimit te organit administrativ.

Pergjegjesia e Ortakeve per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

**Neni 6**

## **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj. Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet te gjallëve duhet te bëhet në formë notierale dhe të regjistrohet. Ne rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshtpërblim, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Për sa kohë që kapitali themeltar i Shoqërisë zotërohet nga dy ortakët e sipërpermendur, këta të fundit do të ushtrojnë kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë se Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

#### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

### **Neni 12** **Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13** **Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi: **Z. Arben Kocollari**, shtetas shqiptar, lindur më 04/05/1981 në Tiranë (ALB) e banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I10504162Q, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

### **Kreu IV**

#### **Viti finanziar-ekspertet**

### **Neni 14** **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

**Neni 15**  
**Ekspertet**

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

**Neni 16**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 17**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 18**  
**Baza Ligjore**



Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 19  
Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te lind midis Shoqërisë dhe te tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

Ky Statut mund te ndryshohet, zevendesohet ose te shfuqziohet plotesisht nga një Statut i ri i miratuar nga Asambleja e Ortakeve.

Ky Statut i Shoqerise “FIRST CONSTRUCTION” SH.P.K u hartua ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe dhe 3 (tre) kopje ne gjuhen angleze, me te njejtën vlerë secila dhe u nenshkrua rregullisht nga Ortaket

**ORTAKET THEMELUES**

**Arben Kocollari**



**Serafima Abramovich**

